

VENDIM
Nr. 560, datë 29.7.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PUBLIKE PËR DHËNIEN NË
ADMINISTRIM INDIREKT TË PASURIVE KULTURORE PERSONAVE FIZIKË
OSE JURIDIKË, PUBLIKË OSE PRIVATË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 171, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave publike për dhënie në administrim indirekt të pasurive kulturore në pronësi publike personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, dhe përcaktimi i kushteve të kontratës për dhënie në administrim indirekt të pasurisë kulturore.

2. Administrimi indirekt i pasurive kulturore ka për qëllim mbrojtjen, ruajtjen, restaurimin, vlerësimin e pasurive kulturore, dhënie në përdorim të tyre, si dhe të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve.

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Këto procedura zbatohen për administrimin indirekt të pasurive kulturore nëpërmjet personave fizikë apo juridikë, publikë apo privatë.

2. Përjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi pasuritë kulturore me vlera arkeologjike, si dhe pasuritë kulturore që gëzojnë statusin “me rëndësi universale” ose “me rëndësi kombëtare”.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të përcaktuar në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

III. KRITERET E PËRGJITHSHME QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET PËR MARRJEN NË ADMINISTRIM INDIREKT TË PASURISË KULTURORE

1. Dhënia në administrim indirekt e pasurisë kulturore sipas këtij vendimi bëhet në favor të personave fizikë, të regjistruar si subjekte tregtare apo juridike, publike ose private, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të kenë pjesë të objektit të veprimtarisë aktivitet në fushën e trashëgimisë kulturore;
- b) të mos jenë në ndjekje penale ose të dënuar për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore ose që lidhen me aktivitetin profesional;
- c) të mos jenë në procedurë likuidimi, falimentimi apo forma të tjera administrimi;
- ç) të kenë eksperiencë në fushën e menaxhimit të përgjithshëm dhe në fushën e trashëgimisë kulturore, brenda ose jashtë vendit, prej jo më pak se 5 (pesë) vjetësh;
- d) të kenë ekspertizën e nevojshme për kryerjen e funksioneve ruajtëse dhe mbrojtëse, sipas natyrës së pasurisë kulturore, referuar legjislacionit në fuqi në fushën e trashëgimisë kulturore;
- dh) të kenë një plan biznesi, i cili duhet të përmbajë një model administrimi që garanton ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin e qëndrueshëm, promovimin, gëzimin publik të pasurisë kulturore në përputhje me planin e menaxhimit të miratuar për atë pasuri;
- e) të kenë burimet e mjaftueshme financiare për të ndërmarrë administrimin e pasurisë kulturore;
- ë) të deklarojnë burimin/et e të ardhurave;
- f) të kenë kapacitetet teknike, ekonomike dhe ligjore për të marrë përsipër administrimin indirekt të pasurisë kulturore të paluajtshme.

2. Subjekti konkurrues paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) ekstraktin historik të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- b) dokumentacion nga organet kompetente mbi gjendjen gjyqësore;
- c) ekstraktin nga regjistri i pronarëve përfitues në rastin e personave juridikë privatë;
- ç) dokumentacionin nga organet tatimore, që vërteton se ka shlyer të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për sistemin e taksave dhe tatimeve në Republikën e Shqipërisë, dokumentacion që vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike dhe ujit;
- d) dokumentacionin provues mbi zotërimin e mjeteve financiare për të zhvilluar projektin e marrjes në administrim të pasurisë kulturore;
- dh) vetëdeklarimin mbi ligjshmërinë e burimit të të ardhurave;
- e) bilancin e 5 (pesë) vjetëve të fundit, të depozituar dhe të konfirmuar nga organet e administratës tatimore;
- ë) vërtetimin dhe/ose kontratat për projektet e realizuara në fushën e trashëgimisë kulturore dhe eksperiencat në menaxhimin e përgjithshëm gjatë 5 (pesë) viteve të fundit;
- f) vetëdeklarimin se subjekti konkurrues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim;
- g) letër për shprehje interesi, ku identifikohet pasuria kulturore publike, e cila kërkohet të merret në administrim indirekt;
- gj) projektpropozimin për zhvillimin e aktivitetit të administrimit dhe aktiviteteve të tjera të parashikuara nga ligji nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- h) plan-biznesin e detajuar për administrimin efektiv të pasurisë kulturore ku duhet të jetë i përshkruar qartë plani i punës, plani i investimit, afati i kthimit të investimit, treguesit që do të realizohen, si dhe mënyra e shpërndarjes së të ardhurave;
- i) një deklaratë në të cilën pranon zbatimin e planit të menaxhimit të miratuar, nëse ka një të tillë;
- j) planin e kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse, mbrojtëse ose restauruese.

3. Në rastin kur pronari i pasurisë kulturore është njësi e vetëqeverisjes vendore, pasuria kulturore jepet në administrim indirekt, sipas parashikimeve të këtij vendimi, pas dhënies së miratimit nga Këshilli Bashkiak.

4. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, subjekti konkurrues skualifikohet nga procedura e konkurimit.

5. Dokumentet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, duhet të jenë origjinale ose të njësuara me origjinalin, si dhe duhet të jenë lëshuar jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e aplikimit.

IV. PROCEDURA PËR DHËNIEN E PASURISË KULTURORE NË ADMINISTRIM INDIREKT

1. Procedura për dhënien në administrim indirekt të pasurive kulturore personave fizikë apo juridikë, publikë apo privatë, nis me propozim të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore (KKMPK).

2. Vendimi i KKMPK-së për propozimin e dhënies në administrim indirekt sipas kësaj procedure përmban:

- a) pasurinë kulturore që propozohet për kalim në administrim indirekt;
- b) metodologjinë për vlerësimin, pikëzimin dhe dhënien e bonusit.

3. Pas njohjes me vendimin e KKMPK-së, sipas pikës 2, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore nxjerr urdhrin për shpalljen e procedurave publike për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore.

4. Urdhri për shpalljen e procedurës publike përmban:

- a) të dhënat mbi pasurinë kulturore, si lloji, emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i administrimit dhe objektivat e pritshëm;
- b) të dhënat mbi genplanin ose hartën e pasurisë dhe të planit të menaxhimit të miratuar;

c) aktivitetet dhe veprimtaritë e administrimit të lejuara dhe që mund të ushtrohen në pasurinë kulturore;

ç) afatin e lidhjes së kontratës;

d) përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave;

dh) njoftimin e kontratës tip dhe kushteve të panegociueshme dhe të negociueshme;

e) datën, orën dhe vendin ku do të paraqiten dokumentet e subjekteve konkurruese;

ë) dokumentacionin që duhet të paraqitet në konkurrim nga subjektet e interesuara, sipas pikës 2, të kreut III.

5. Njoftimi për botim i shpalljes së procedurës publike për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës. Njoftimi qëndron i publikuar për 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

6. Komisioni i vlerësimit të ofertave shqyrton dhe vlerëson dosjet e subjekteve konkurruese, sipas këtij vendimi dhe vendimit të KKMPK-së, sipas pikës 2 të këtij kreu, mbi baza krahasimore të projekteve të propozuara.

7. Mungesa e dokumentacionit apo mospërbushja e kriterëve, sipas këtij vendimi sjell skualifikimin e subjektit pjesëmarrës.

8. Pas shqyrtimit të kriterëve formale ligjore, nëse dokumentacioni i paraqitur konsiderohet me të meta, subjekti i interesuar njoftohet me shkrim për mangësitë, duke i caktuar afatin 5-ditor (pesëditor) për plotësimin e të metave.

9. Procesi i vlerësimit vazhdon edhe kur është paraqitur së paku një ofertë e vlefshme. Ofertë e vlefshme konsiderohet oferta që nuk shkualifikohet sipas parashikimeve të këtij vendimi.

10. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit, komisioni i vlerësimit të ofertave përcakton renditjen e subjekteve pjesëmarrëse të kualifikuara, sipas pikëve të përfituara, si dhe përcakton listën e subjekteve të shkualifikuara.

11. Vendimi për vlerësimin i përcillet ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe shpallet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

12. Subjektet konkurruese, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Depozitimi i ankimit pezullon procedurën deri në shqyrtimin e tij nga ministri. Ministri shqyrton ankimin dhe shprehet me vendim të arsyetuar dhe njofton ankuesin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e ankimit.

13. Pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 12 të këtij kreu ose vendimit të ministrit, ministri njofton fituesin për lidhjen e kontratës për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore.

14. Fituesi, përpara lidhjes së kontratës, duhet të paraqesë garancinë e kontratës në masën 5% të vlerës së investimit të miratuar, garanci e lëshuar nga një institucion financiar bankar ose jobankar, që ushtron aktivitet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kthimi i garancisë së kontratës realizohet pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet e kontratës për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore.

V. KONTRATA PËR DHËNIEN NË ADMINISTRIM INDIREKT TË PASURISË KULTURORE

1. Kontrata tip për dhënien në administrim indirekt të pasurive kulturore përmban minimalisht kushtet kontraktuale të mëposhtme:

a) përmbajtjen e projektit të administrimit;

b) shërbimet thelbësore që duhen garantuar për shfrytëzimin publik të objektit;

c) afatet e realizimit;

ç) nivelet cilësore të aktivitetëve dhe të shërbimeve që do të ofrohen;

d) kërkesat për nivelin profesional të punonjësve;

dh) afatin e kontratës;

e) zbatimin e planit të menaxhimit, nëse ka një të tillë;

- ë) detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve;
- f) format e shpërblimit të dëmit dhe penalitetet;
- g) mënyrën e kthimit të investimit;
- gj) mënyrën e zbatimit të tarifave;
- h) mënyrën e shpërndarjes të të ardhurave;
- i) procedurat për zgjidhjen e kontratës;
- j) procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- k) procedurat për monitorimin e zbatimit të kontratës.

2. Kohëzgjatja e kontratës së dhënies në administrim indirekt të pasurive kulturore është nga 1 deri në 10 vjet.

3. Afatet e parashikuara në pikën 2 të këtij kreu, janë të rinovueshme vetëm 1 herë dhe në çdo rast afati i rinovuar nuk mund të jetë më shumë se afati fillestar i kontratës.

4. Kontrata e dhënies në administrimin indirekt në asnjë rast nuk nënkupton dhënien e pronësisë së pasurisë kulturore, e cila mbetet pasuri shtetërore në çdo rast.

5. Në rast se subjekti i shpallur fitues lidh kontratë të posaçme për shfrytëzimin e hapësirave të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, në përputhje me kontratën për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore, kjo kontratë e posaçme i bashkëlidhet kontratës për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore. Anulimi i kontratës për dhënien në administrim indirekt të pasurisë kulturore sjell automatikisht anulimin e kontratës për hapësirat, pa të drejtë dëmshpërblimi.

6. Kontrata zgjidhet në mënyrë të menjëhershme në rastet kur subjekti, që merr në administrim indirekt pasurinë kulturore:

- a) nuk siguron masat ruajtëse dhe mbrojtëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë;
- b) nuk zbaton planin e miratuar të mirëmbajtjes;
- c) nuk merr masat e menjëhershme në rast rreziqesh, të konfirmuara, sipas vendimmarrjeve të organeve kompetente sipas ligjit për trashëgiminë kulturore;
- ç) nuk përmbush kushtet e parashikuara në kontratë.

7. Në rast se kontrata zgjidhet nga subjekti konkurrues për shkaqe, për të cilat autoriteti kontraktues nuk mund të mbajë përgjegjësi, garancia e parashikuar në pikën 14, të kreut IV, mbahet si penalitet.

8. Në rast të zgjidhjes së kontratës ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore apo strukturat e tjera kompetente kanë të drejtë të ndërhyjnë menjëherë, sipas parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë për të siguruar ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore.

9. Ushtrimi i veprimtarisë së subjektit administrues në bazë të kontratës së administrimit indirekt monitorohet sipas rregullave të monitorimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama